



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE *MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 39 dhe 40 të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 17.05.2007 merr:

V E N D I M
PËR SHQYRTIM PUBLIK TË PROPOZIMPLANIT TË VEPRIMIT PËR
TRANSPARENÇË

Neni I

Miratohet Vendimi për shqyrtimin publik të Propozimplanit të veprimit për transparence.

Neni II

Shqyrtimi publik i propozimplanit të veprimit për transparencë sipas këtij Vendimi, zgjat 30 ditë, duke llogaritur nga dita e pare vijuese pas miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës. Organizimin e shqyrtimit publik të propozim planit sipas këtij Vendimi, do ta bëjë Zyra për marrëdhënie me publikun.

Neni III

Pas përfundimit të shqyrtimit publik të propozimplanit nga neni 1 i këtij Vendimi, do t'i prezantohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim përfundimtarë.

Neni IV

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Neni V

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr. 031-205 dt.17.05.2007

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri